



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:002318

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05526682

P.nr.34/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me procesmbajtësen Elheme Kastrati, në lëndën penale ndaj të akuzuarve: Q.M dhe G.M, që të dy nga ..., rruga “...” nr.... dhe I.M nga ..., rruga “...” nr...., që të tre nga Komuna e Drenasit, të akuzuar për vepër penale, e kryer nga secili veç e veç Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.5572/2020, datë.28.12.2020, sipas detyrës zyrtare, jashtë shqyrtimit, me datë **29.03.2024**, merr këtë:

A K T V E N D I M

MIRATOHET marrëveshja e arritur për zgjidhjen e ndërmjetësuar të çështjes penale, e lidhur me dt.15.03.2024, në Zyrën për Ndërmjetësim në Prishtinë, në mes të akuzuarve: Q.M dhe G.M, që të dy nga ..., rruga “...” nr.... dhe I.M nga ..., rruga “...” nr...., që të tre nga Komuna e Drenasit dhe e ka fuqinë e titullit ekzekutiv sipas ligjit për procedurën përmbartimore, ashtu që **HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë PP.II.nr.5572/2020, datë.28.12.2020, dhe **NDËRPREHET PROCEDURA PENALE** ndaj të akuzuarve Q.M, G.M dhe I.M, të akuzuar për vepër penale, e kryer nga secili veç e veç Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), pasi që gjatë rrjedhës së procedurës penale të zbatuar pranë kësaj gjykate është vërtetuar se është arritur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar të kësaj çështje penale.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjete buxhetore.

Ndërsa shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit duhet të paguhen proporcionalisht nga palët, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.5572/2020, datë.28.12.2020, ka akuzuar të akuzuarit për vepër penale, e kryer nga secili veç e veç Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Kjo gjykatë ka caktuar shqyrtimin fillestar gjyqësor me dt.07.03.2024, dhe gjatë rrjedhës së procedurës penale të zbatuar pranë kësaj gjykate, gjykata ka referuar çështjen në ndërmjetësim dhe palët janë pajtuar për të shkuar në ndërmjetësim dhe gjykata i ka informuar dhe udhëzuar palët në procedurë të ndërmjetësimit në Zyrën për Ndërmjetësim në Prishtinë, këtë duke u bazuar

në nenin 2. par.1 dhe 2., 4, 5, 8.par.1., 8.par.2. dhe 8.par.7. të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës /Nr.14/20 Gusht 2018, Prishtinë, e lidhur me nenin 229 par.1. të KPP-së.

Të akuzuarit me dt.15.03.2024, kishin arritur marrëveshje për zgjidhjen e ndërmjetësuar të kësaj çështje penale. Për të cilën marrëveshje për ndërmjetësim, gjykata është njoftuar duke e pranuar në dorëzim me dt.29.03.2024 nga ky zyre.

Nga këto shkaqe duke patur parasysh se të akuzuarit, kishin arritur marrëveshje për zgjidhjen e ndërmjetësuar të çështjes penale, gjykata në bazë të nenit 15 par.1. të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës /Nr.14/20 Gusht 2018, Prishtinë, kishte miratuar marrëveshjen e arritur për zgjidhjen e ndërmjetësuar, e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv sipas ligjit për procedurën përmbartimore, bazuar në nenin 229 par.6. të KPP-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 229 par.5. të KPP-së, merr aktvendim për hudhjen e aktakuzës dhe ndërprerjen e procedurës penale ndaj të akuzuarve Q.M, G.M dhe I.M, pasi që gjykata ka marrë njoftimin për arritjen e marrëveshjes.

Vendimin që shpenzimet e procedurës penale të bijën në barrë të mjeteve buxhetore e bazoi në nenin 453 par.1. të KPP-së.

Vendimin që shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit duhet të paguhen proporcionalisht nga palët, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe, e bazoi në nenin 19 par.1. të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës /Nr.14/20 Gusht 2018, Prishtinë.

Nga e lartëtheksuara në bazë të nenit 25 par.2. lidhur me nenin 229 par.5. dhe par.6. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.34/2024, datë 29.03.2024.

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

Gj y q t a r i
Shfqet Baleci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 3 (tre) ditë, nga dita e pranimit në dorëzim, përmesë kësaj dege të gjykatës, në tre kopje.